

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
Adresa : Adresa: Rr.Lord Bajron, Nr.70, Laprakë, Tiranë
E-mail: info@urgjenca.gov.al
Faqja e Internetit: urgjenca.gov.al

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlere te vogel me objekt:
“Shërbime dezinfektimi për ambientet dhe autoambulancat e QKUM-së me rastin e përhapjes së COVID-19”.

Data e zhvillimit do të jetë **12.03.2020, ora 16:00** në adresën
www.<http://www.app.gov.al>app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

Objekti: **“Shërbime dezinfektimi për ambientet dhe autoambulancat e QKUM-së me rastin e përhapjes së COVID-19”.**

Nr	Emertimi i shërbimeve	Nj	Sasia	Çmimi	Vlefta
1	Dezinfektim i ambienteve të QKUM-së	m ²	1291. 5		
2	Shërbim dezinfektimi autoambulancash dhe automjetesh të QKUM-së, sa herë që ka raste transport pacientësh të infektuar me COVID-19	Autoambulance/automjet	1		
3	Shuma				

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor, dokumentet si më poshtë:

- Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- Ekstraktin Historik ku te jete perfshire objekti i prokurimit. Operatori Ekonomik duhet të ketë në objektin e veprimtarisë tregtimin e materialeve të kërkuara në këtë procedure.

- Formularin e ofertes ekonomike. *Kujdes: Operatorët ekonomikë do të ofertojnë me cmim për njësi, cmim për cdo dezinfektim autoambulance/automjeti, pasi AK e ka të pamundur të përlllogarisë numrin e deinfektimeve që do të kryhen në automabulanca dhe automjete, që do të bëjnë transport të personave të infektuar me COVID-19, deri në fund të vitit. Do të kryhen aq dezinfektime sa nuk tejkalojnë vlerën limit të blerjeve me vlerë të vogël.*
 - Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale nga Administrata Tatimore.
 - Nje vërtetim që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.
 - Vërtetim bankar për numrin e llogarisë së bashku me IBAN.
 - Operatori Ekonomik duhet ta ketë selinë e aktivitetit të tij në Tiranë për arsye të dinamikës së kryerjes së shërbimit dhe përgjigjes 24 orë në rast të problemeve apo kërkesave, kryerjes së shërbimit në orët e vona të natës etj. Për këtë arsye, është e nevojshme që OE të ketë selinë në Tiranë, në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesave të AK. *Për kryerjen e shërbimit objekt Prokurimi do të punohet kryesisht natën (duke pasur parasysh frekuentimin e lartë të këtyre hapësirave dhe praninë e fëmijëve, të grave shtatëzana, të të moshuarve etj) apo në raste urgjente (me kërkesë) dhe përgjigjia duhet të kryhet brenda një kohe shumë të shpejtë. Për këtë arsye është e nevojshme që operatori të ketë selinë në Tiranë për zbatimin e kërkesave të AK.*
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit të kryera gjatë tri viteve të fundit.
- Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore ku të jenë shënuar datat, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon:
- Liçencën nga QKL (te vlefshme) për kryerjen e shërbimit DDD

Mbi bazë të kërkesave ligjore, operatorët duhet të disponojnë këtë Licencë për ushtrimin e shërbimeve objekt prokurimi

- Liçencën për Shërbime Ndërhyrëse Higjeno-Sanitare me Kod II.8.A (te vlefshme)

Kjo Licencë lidhet me disponimin e Licencës së mësipërme, gjë që garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë

- Aktin e miratimit higjeno-sanitar për magazinën/vend-ruajtjen e preparateve DDD dhe për të paktën 1 automjet transporti (në bazë nenit 12 të ligjit nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar)

Në bazë të kërkesave ligjore në fuqi, vjen dhe kjo kërkesë, e cila është detyrim për çdo operator që ushtron shërbime profesionale DDD.

- Operatori i shërbimit duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme.
- ISO 18001 për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në qëllimin e të cilit të përfshihet objekti i këtij prokurimi
- ISO 9001 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, në qëllimin e të cilit të përfshihet objekti i këtij prokurimi
 - Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **1 Ing. Kimist**, vërtetuar kjo me Kontratë Pune, Diplomë ose/dhe certifikata Trajnimesh.

Specifikimet teknike:

1. Shërbimi duhet të kryhet brenda 2 ditëve nga shpallja fitues për ambientet e QKUM-së dhe pas kryerjes së shërbimit, Operatori duhet të lëshojë Certifikatë/Dëshmi Pest Control me afat 6-mujor. Ambientet e QKUM-së kanë një sipërfaqe totale prej 1291.5 m2, ambientet e brendshme dhe të jashtme.
2. Shërbimi në autoambulanca dhe automjete duhet të kryhet brenda 2 orëve nga lajmërimi i QKUM-së. Dezinfektimi i autoambulancave dhe automjeteve të QKUM-së do të bëhet në cdo rast që ka transport pacientësh të infektuar me COVI-19. Gjithsej 9 autoambulanca+ 2 automjete të vogla.

Në rast të problemeve të mundshme që mund të shfaqen, operatori duhet të përgjigjet brenda 2 orëve për të ndërhyrë në varësi të problematikës

3. Produkti që do të përdoret duhet të jete dizinfektant pa kuaternare amonumi, të rekomandohet për përdorim spitalor, në shkolla ndërtesa publike etj. Substanca aktive: aminopril, dodekilpropan, diamine. Produkti duhet të jetë specifik kundër viruseve të kapsuluara (si corona virus). Për të vërtetuar kete, operatori duhet të paraqese skeden teknike të produkteve dhe faturat e blerjeve, pasi produkti duhet të jete gjendje, për cdo kerkese emergjente.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda 24 oreve nga njoftimi i klasifikimit. Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Skënder Brataj